



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT  
GJIROKASTËR**

Nr \_\_\_\_\_ Prot.

Gjirokastër më 02.02 .2018

**ANALIZË**  
**MBI TREGUESIT E PUNËS SË KRYER GJATË VITIT 2017**

Prokuroria e Apelit Gjirokastër, duke ju referuar shqyrtimeve gjyqësore të apeliemeve të ardhura nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet gjatë vitit 2017 ka shqyrtuar 178 çështje themeli, me 218 të pandehur nga të cilët 150 me masë sigurimi “arrest burg”, ka shqyrtuar 140 çështje me 145 persona të dyshuar, me objekt vleftësim arresti ose ndalimi dhe caktim mase sigurimi, si dhe ka marrë pjesë në gjykim dhe për 67 çështje gjyqësore penale me objekt kundërshtim vendim pushimi, mosfillimi etj.

**1. Treguesit e përgjithshëm.**

Për vendimet e themelit janë shqyrtuar 80 çështje me 104 të pandehur, nga të cilët 80 me masë sigurimi arrest burg, që i përkasin Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, 83 çështje me 91 të pandehur nga të cilët 59 të pandehur me masë sigurimi “arrest burg” për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë si dhe 15 çështje me 23 të pandehur nga të cilët 11 me masë sigurimi “arrest burg” për rrethin Gjyqësor Përmet. Gjithashtu në Gjykatën e Apelit Gjirokastër janë shqyrtuar dhe 67 çështje penale me objekt gjykim kërkesë për prishjen e vendimit të mosfillimit ose pushimit, rivendosje në afat, me të dëmtuar akuzues, kundërshtim zgjatje afati paraburgimi etj.

Për vitin 2018, janë mbartur 15 çështje, me 19 të pandehur nga të cilët 2 me masë sigurimi “arrest burg”, Nga të cilat 10 çështje janë me apelim të të pandehurit, 5 çështje të apeluara nga prokuroria.

**2. Treguesit për vendime themeli.**

Duke ju referuar shqyrtimeve të vendimeve të themelit rezulton se 56 apelime, (10 apelime më pak se viti 2016), janë ushtruar nga Prokurorët, ku 24 apelime, (5 më shumë se viti kaluar), janë bërë për pafajsi, 3 apelime për pushim çështje (një më pak se viti kaluar), 5 apelime për ndryshim kualifikimi (dy më shumë nga viti kaluar), dhe 24 apelime për masë dënimi të butë (16 më pak se viti kaluar).

Është hequr dorë nga apelimi e prokurorëve të shkallës së parë në 15 raste( 6 më pak se viti kaluar), ndërsa nga të pandehurit është hequr dorë nga ankimi në 23( 7 më pak se viti kaluar) çështje të gjykuara. Nga Prokuroria e Apelit Gjirokastër janë përkrahur 41 apelime të Prokurorëve. Ndërsa nga të pandehurit janë ushtruar 143 apelime( 57 më pak nga viti kaluar). Nga 20 apelime për pafajsi ose pushim çështje(3 më shumë se viti kaluar) nga Gjykata e Apelit është dhënë fajësi, duke ndryshuar vendimet e gjykatave të shkallës së parë, për 8 vendime. Janë lënë në fuqi 12 vendime për pafajësi ose pushim çështje.

Përsa u përket masave të sigurimit, nga 140 apelime (7 më pak se viti kaluar), 17(27 më pak nga viti kaluar) apelime janë bërë nga Prokuroritë dhe 128( 25 më shumë nga viti kaluar) apelime janë bërë nga personat e dyshuar, ku për 4 apelime( 4 më pak nga viti kaluar) të prokurorëve është hequr dorë nga prokurori Apelit, ndërsa për 3 apelime kanë hequr dorë personat e dyshuar. Nga 16 apelime të Prokurorëve janë pranuar nga gjykata e Apelit 9 apelime duke vendosur masën e sigurisë “arrest burg” ose masa të tjera më të buta dhe në 7 raste është miratuar vendimi gjykatave të shkallës së parë për masë sigurimi. Nga 127( 25 më shumë se viti kaluar) apelime të personave të dyshuar të shqyrtuara, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin duke caktuar masë sigurimi më të butë në 2 raste( 5 më pak se viti kaluar), dhe për 119(17 më shumë se viti kaluar) apelime ka miratuar(lënë në fuqi) vendimin e Gjyktës së Shkallës së Parë. Nga Prokurori Apelit në 4apelime (4 më pak se viti kaluar) për masa sigurimi është hequr dorë, duke lënë në fuqi vendimin e gjyktës së shkallës së parë.

Nga shqyrtimi apelimeve për vendime themeli, gjithsej 56( 10 më pak nga viti kaluar), të ushtruara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Gjirokastër, Sarandë, Përmet, nga prokuroria e Apelit janë pranuar 41 apelime. Është hequr dorë për 15 apelime, është vendosur mospranim apelimi nga gjykata për 38 raste, është hequr nga apelimi dhe nga të pandehurit në 23 gjykime. Prokuroria e Apelit Gjirokastër në 96(36 më pak se viti kaluar) raste të ushtrimit të apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimeve të Gjykatave të Shkallëve të Para. Janë lënë në fuqi 83 vendime, në 8 vendime është vendosur lehtësimi pozitës së të pandehurit në dënime më të buta, në 3 vendime( 4 më pak nga viti kaluar) është dhënë pafajsi ose pushim dhe në 2 vendime( 2 më pak nga viti kaluar) është vendosur kthimi për rigjykim. Në 21 gjykime( 8 më pak nga viti kaluar) është kërkuar rrëndimi i

pozitës së të pandehurit. Gjykata ka pranuar 11 apeline (4 më shumë nga viti kaluar) dhe 10 apeline nuk janë pranuar(është lënë në fuqi vendimi Gjyktës së Shkallës së Parë.

Në 9 vendime(6 më pak nga viti kaluar) të Gjykatave të shkallës së parë është kërkuar lehtësimin e pozitës së të pandehurve në masë dënimi ose mënyrë të vuajtjes së dënimit. Gjykata e Apelit në 1 vendim ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, në 7 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve dhe në një vendim ka vendosur pafajsi. Në 4 vendime të Gjykuar në Gjykatën e Apelit është kërkuar kthim i çështjes për rigjykim, kërkesa të cilat janë pranuar nga Gjykata e Apelit.

Në 20 shqyrtime gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, nga Prokuroria jën bërë 20 kërkesa për prishje të vendimit të pushimit ose pafajisë, të vendimeve të gjykatave të shkallëve të para. Gjykata e Apelit ka pranuar 8 kërkesa për prishje të vendimit të pushimit ose pafajisë dhe në 12 vendime ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave të shkallëve të para.

Kërkesat e Prokurorit të Apelit për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë, duke kundërshtuar apelimet e të pandehurve, në 96 vendime(36 më pak se viti kaluar) është përkrahur nga gjykata në 83 vendime, për 8 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve, për 3 vendime(4 më pak nga viti kaluar) ka dhënë pafajsi dhe për 2 vendime(2 më pak nga viti kaluar) ka vendosur kthim të çështjes për rigjykim.

Është rënduar pozita e të pandehurve në lloj dhe masë dënimi në bazë të kërkesës së prokurorit të apelit në 11 raste, nga 21 apeline të shqyrtuara, dhe është lënë në fuqi vendimi gjykatës së shkallës së parë në 10 vendime.

Është pranuar kërkesa e prokurorit të Apelit nga Gjykata sipas ankimit të të pandehurit ose të prokurorit për të lehtësuar pozitën e tij ne 7 raste, ku në 1 vendime është lënë në fuqi vendimi gjykatave të shkallës së parë në 1 vendim është vendosur kthimi akteve për rigjykim.

Gjatë gjykimit të vendimeve të themelit, është dhënë vendim pafajsie nga Gjykata e Apelit në 4 vendime me 4 të pandehur të lirë, ku për secilin vendim është ushtruar rekurs.

Nga Prokuroria ae Apelit janë ushtruar 17 rekurse në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

### **3. Treguesit e vendimeve për masa sigurimi.**

Gjykata e Apelit Gjirokastër në bazë të apelineve të Prokurorëve të rretheve Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet si dhe të personave të dyshuar ,të gjykuar në këto rrethe, ka shqyrtuar 140 çështje(7 çështje më pak se viti kaluar) me 145 pesroan,

17 apeline(27 më pak se viti kaluar) janë ushtruar nga Prokuroritë e Rretheve dhe 128 apeline janë ushtruar nga të pandehurit(personat e dyshuar nën hetim), 26 apeline më shumë se viti kaluar. Ku 58 apeline i përkasin Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, 67 apeline Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe 15 apeline Rrethit Gjyqësor Përmet. Ku nga Prokuroria e Apelit janë përkrahur 12 kërkesa për ndryshim mase sigurimi duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest burg” dhe në 4 raste masë sigurimi më të butë. Nga Gjykata e Apelit në 5 vendime është ndryshuar vendimi Gjykatave të shkallës së parë duke caktuar masë sigurimi “Arrest burg”, ndërsa në 4 raste nga Gjykata e Apelit është ndryshuar masa e sigurimit nga “Arrest burg” në një masë më të butë sigurimi dhe në 7 vendime ka lënë në fuqi(miratuar) vendimin e gjykatave të shkallës së parë. Nga këto shqyrtime gjyqësore rezulton se 17 apeline janë bërë nga prokurorët e seancave kundër masave më të lehta të vendosura nga Gjykatat e shkallës së parë dhe 128 apeline janë bërë nga të pandehurit ku kërkohej masa më të buta sigurimi. Gjykata e apelit Gjirokastrë në bazë të apeliemve në 7 raste ka vendosur mospranim ankimi( në 4 apeline ka hequr dorë prokurori apelit, në 3 apeline ka hequr dorë personi dyshuar). Në 5 apeline Gjykata e Apelit ka ndryshuar masën e sigurimit sipas kërkesave të prokurorit dhe në 2 raste ka zbutur masën e sigurimit në masa më të buta. Prokuroria e Apelit në 128 apeline të të pandehurve për masa më të buta sigurimi ka kërkuar miratimin e vendimeve të Gjykatave të Shkallës së Parë në 121 raste, ndërsa Gjykata e Apelit ka miratuar 119 vendime(lënë në fuqi) dhe në 2 raste ka dhënë vendime për masa më të buta sigurimi.

Nga Prokuroria e Apelit është ushtruar një rekurs në Gjykatë e Lartë, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

### **Rrethi Gjyqësor Gjirokastrë:**

Janë apeluar 80 vendime themeli (29 më pak se viti kaluar) me 104 të pandehur, nga të cilët 80 me masë sigurimi “arrest burg” . Nga këto 28 apeline janë ushtruar nga Prokurorët( 6 më pak nga viti kaluar) dhe 70 vendime janë apeluar nga të pandehurit( 17 më pak nga viti kaluar). Pra Prokuroria e Gjirokastrës ka apeluar 28 vendime( 6 më pak se viti kaluar), nga të cilët 14 për pafajsi, 3 për pushim çështje, 3 për ndryshim kualifikimi dhe 8 vendime për masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 70 vendime. Ka 8 raste të heqjes dorë nga prokurori apelit dhe 9 raste kanë hequr dorë nga ankimi të pandehurit. Nga Prokurori Apelit janë bërë 42 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 37 vendime ka vendosur lënie në fuqi, në 3 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve, në një vendim ka vendosur pafajsi dhe në një vendim ka vendosur kthim të çështjes për rigjykim. Nga 8 apeline të prokurorisë Gjirokastrë për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit në 4 vendime ka pranuar

apelimin duke rënduar pozitën e të pandehurit, në 4 vendime ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së pare. Nga 9 apelime të Prokurorisë Gjirokastër për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit në 5 raste ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë dhe në 4 vendime ka vendosur fajësi, për të gjitha këto vendime (pafajsi) nga Prokuroria e Apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga Rrethi Gjyqësor Gjirokastër janë ushtruar 60 apelime për masa sigurimi (19 apelime më pak se viti kaluar), ku 11 apelime janë ushtruar nga Prokuroria dhe 49 nga personat e dyshuar, të arrestuar ose ndaluar. Në një apelim të prokurorisë shtë hequr dorë nga prokurori Apelit. Nga shqyrtimi i 10-të apelimeve të Prokurorisë Gjirokastër, Gjykata e Apelit në 4 vendime ka pranuar apelimin duke vendosur masën e sigurimit “arrest burg”, në 6 vendime ka miratuar (lënë në fuqi) vendimin e gjyktës së shkallës së pare.

### **Rrethi Gjyqësor Sarandë:**

Janë apeluar 83 vendime themeli (32 më pak se viti kaluar) me 91 të pandehur (39 më pak se viti kaluar), nga të cilët 59 me masë sigurimi “arrest burg”. Prokuroria ka apeluar 18 vendime (4 më pak se viti kaluar), nga të cilët 5 për pafajsi, 1 për ndryshim kualifikimi dhe 12 vendime për masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 66 vendime (39 më pak se viti kaluar).

Prokurori Apelit në 6 raste ka hequr dorë nga apelimi ndërsa të pandehurit kanë hequr dorë nga apelimi në 13 raste. Nga Prokurori Apelit janë bërë 43 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 37 vendime ka vendosur lënie në fuqi, në 4 vendime ka vendosur lehtësimin e pozitës së të pandehurve, në 1 vendim ka vendosur pafajsi, dhe në 1 vendim ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim. Nga 8 apelime të prokurorisë Sarandë për rrëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit 4 vendime ka vendosur lënie në fuqi, ndërsa 4 vendime ka vendosur, rëndimin e pozitës së të pandehurit. Nga 6 apelime (tre më shumë nga viti kaluar) të Prokurorisë për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit në 3 raste ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë dhe në 3 vendime ka vendosur fajësi, (rezultat i mire). Nga Rrethi Gjyqësor Sarandë janë ushtruar 67 (9 më shumë nga viti kaluar) Apelime për masa sigurimi, ku 2 aplime (10 më pak ng viti kaluar) janë ushtruar nga Prokuroria dhe 68 apelime nga personat e dyshuar. Është hequr dorë nga Prokurori Apelit nga 1 apelim dhe në 1 rast kanë hequr dorë të dyshuarit. Në një rast Gjykata e Apelit ka pranuar apelimin duke vendosur masën e sigurimit “arrest burg” të kërkuar nga prokuroria.

### **Rrethi Gjyqësor Përmet:**

Janë apeluar 15 vendime themeli themeli (3 më pak se viti kaluar) me 23 të pandehur, nga të cilët 11 me masë sigurimi “arrest burg”. Prokuroria ka apeluar 10 vendime (sa viti kaluar), nga të cilët 5 vendime për pafajsi, 1 vendim për ndryshim kualikimi, një për pushim çështje dhe 4 vendime për masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 7( 1 më pak nga viti kaluar) vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë. Në një rast nga apelimi është hequr dorë nga prokurori apelit. Nga Prokurori Apelit janë bërë 11 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 9 vendime ka vendosur lënie në fuqi, në 1 vendim ka vendosur pushim çështje dhe një rast gjykimi ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rigjykim. Nga 5 apeline të prokurorisë Përmet për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit në 2 vendime ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së parë dhe 3 vendime ka vendosur rëndimin e pozitës së të pandehurve në masë dënimi dhe mënyrë të vuajtjes së dënimit. Nga një kërkesë të prokurorit të Apelit për lehtësim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit e ka pranuar duke lehtësuar pozitën e të pandehurit. Nga 5 apeline të Prokurorisë Përmet për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit ka pranuar 1 apelim, ku ka vendosur prishje të vendimit të pafajsisë dhe ka vendosur fajësi për të pandehurit, dhe në katër vendime ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Nga Rrethi Gjyqësor Përmet janë ushtruar 15 apeline(5 më shumë nga viti kaluar) për masa sigurimi, ku 4 apeline janë ushtruar nga Prokuroria dhe 11 nga personat e dyshuar. Nga 4 apeline të prokurorisë Përmet, një 3 raste është hequr dorë nga ankimi, një apelim është përkrahur dhe Gjykata e Apelit ka vendosur pranimin e aplimit duke vendosur masën e sigurimit të kërkuar. Në 11 apeline të personave të dyshuar Gjykata e Apelit ka miratuar(lënë) në fuqi 10 vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe një rast ka pranuar apelimin e personit të dyshuar duke dhenë një masë dënimi më të butë.

#### **4. Vendimet e themelit të apeluara sipas veprave penale.**

Në krahasim me vitin e kaluar, gjatë vitit 2017, në Gjykatën e Apelit Gjjirokastër janë shqyrtuar 389 çështje themeli, 57 çështje më shumë se viti kaluar, duke përfshirë dhe shqyrtimet e çështjeve që nuk pasqyrohen në statistikë (kundërshtim vendim pushimi/mosfillimi, rivendosje në afat, zgjatje afati hetimi dhe paraburgimi etj).

Prokurori Apelit Alfred Agolli, ka marrë pjesë në 224 çështje penale të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit Gjjirokastër, ndërsa prokurori Gjon Fusha ka marrë pjesë në 165 çështje penale të shqyrtuara në gjykatën e Apelit Gjjirokastër.

Rrastet e gjykuara sipas veprave penale vepra penale më të shumta janë si më poshtë:

- Për nenin 283 të K.Penal(prodhim shitje narkotikëve), gjithsej janë shqyrtuar 22 apeline( 7 apeline më pak se viti kaluar), ku 2 apeline janë ushtruar nga prokurorët, nga të cilat 1 apelim për ndryshim kualifikim dhe 1 apelim për masë të butë dënimi. Nga apelimet e prokurorëve është pranuar 1 apelim nga Gjykata e Apelit duke rënduar pozitën e të pandehurit në masë dënimi dhe është vendosur mospranim ankimi për një apelim, pasi është hequr dorë.
- Për nenin 284 të K.Penal(kultivimi narkotikëve) janë shqyrtuar 8 çështje penale( 4 më pak nga viti kaluar), ku 3 apeline janë ushtruar nga prokuroria për masë të butë dënimi, ku Gjykata e Apelit ka pranuar apelimin duke rënduar masën e dënimit për të pandehurit. Ndrësa për 5 apelimet e të pandehurve Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.
- Për nenin 134 të K.Penal(vjedhja) janë shqyrtuar 25 apeline(12 apeline më pak se viti kaluar), ku 2 apeline të ushtruar nga prokurorët dhe 24 nga të pandehurit. Është pranuar apeliti nga Prokuroria e Apelit në të dy rastet të apelineve të prokurorëve. Gjykata e Apelit ka pranuar një nga apelimet e prokurorëve duke prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe ka dhënë fajësi. Në 24 apeline të të pandehurve, 21 vendime janë lënë në fuqi, në tre vendime është lehtësuar pozita e të pandehurve.
- Për nenin 278( prodhimi dhe mbajtja pa lejë e armëve luftarake dhe municionit) të K.Penal janë shqyrtuar 7 vendime me 10 të pandehur me masë sigurimi “arrest burg” , ku dy apeline janë ushtruar nga prokuroria për ndryshim kualifikimi e masë të butë dënimi, ndërsa 7 apeline nga të pandehurit, të cilat nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Për dy apelimet e prokurorisë është hequr dorë nga prokurori apelit.
- Për nenin 199/a të K.Penal(ndërtimi paligjshëm) në Gjykatën e Apelit është shqyrtuar 1 çështje penale me ankim të prokurorisë për pushim çështje ku Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.
- Për nenin 248 të K.Penal(shpërdorimi detyrës) janë shqyrtuar 5 çështje penale me 11 të pandehur nga të cilët 3 me masë sigurimi “arrest burg”. Nga prokuroria e shkallës së parë janë ushtruar 3 apeline ndërsa nga të pandehurit 2 apeline. Gjykata e Apelit në 3 rastet e apelimet të prokurorisë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë(pafajësi) ku nga prokuroria e Apelit është ushtruar recurs. Dhe për tre apelimet e të pandehurve ka vendosur lënien lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë(fajësi).
- Për nenin 259 të K.Penal(korupsioni pasiv) për vitin 2017 nuk është shqyrtuar asnjë apelim.
- Për nenin 290 të K.Penal(shkelje rregullave të aqrkullimit rrugor) janë shqyrtuar 11 apeline, 3 apeline të ushtruara nga prokuroria për pafajsi dhe 8 apeline

nga të pandehurit. Gjykata e Apelit nga tre apelimet e prokurorisë ka pranuar një apelim duke vendosur fajësi për të pandehurin, dhe në dy apime ka lënë fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë(pafajsi). Në dy apime të të pandehurve gjykata ka vendosur lehtësimin e pozitive në masë dënimi.

- Për nenin 130/a të K.Penal(dhuna në familje) janë shqyrtuar 7 apime( 7 më pak se viti kaluar), ku 4 apime janë ushtruar nga prokuroria për pafajsi dhe masë dënimi të butë. Ndërsa nga të pandehurit janë ushtruar 4 apime. Gjykata e Apelit për një apelim të prokurorisë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa për dy apime ka vendosur pranimin e apelit të prokurorisë duke ndryshuar vendimet e shkallës së nga pafajësi në fajësi. Apelimet e të pandehurve nuk janë pranuar, janë lënë në fuqi vendimet e gjykatës së shkallës së parë.
- Për nenin 298 të K.Penal(ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit) janë shqyrtuar 3 apime me 5 të pandehur me masë sigurimi “arrest burg), një apelim i ushtruar prokuroria për masë të butë dënimi dhe 4 apime i kanë ushtruar të pandehurit. Gjykata e Apelit për apelimin e prokurorisë ka vendosur pranimin e apelimet duke rrënduar pozitën e të pandehurit. Ndërsa për apelimet e të pandehurve ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.
- Për nenin 76 të K.Penal(vrasja), është shqyrtuar 1 çështje e apeluar nga Prokurori, për masë dënimi të butë, gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit(është ushtruar recurs).
- Për nenin 76 e 22 të K.Penal(vrasje e ngelur në tentativë), janë shqyrtuar 2 çështje të apeluara nga të pandehurit ku Gjykata për një apelim ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë ndërsa për rastin tjetër ka vendosur kthim për rigjykim(është ushtruar recurs).
- Për nenin 140( vjedhje me armë) janë shqyrtuar dy çështje me ankim të të pandehurve, Gjykata e Apelit ka vendosur lënie në fuqi.
- Për nenin 291 të K.Penal(drejtimi mjetit në mënyrë të paregullt) janë shqyrtuar 13 apime( 3 më pak se viti kaluar,kryesisht rrethi Sarandë), ku 2 apime janë ushtruar nga prokurorët dhe 11 apime nga të pandehurit.Nga prokuroria e Apelit është hequr dorë nga 1 apelim dhe është kërkuar lehtësimi pozitës së të pandehurit në mënyrën e vuajtjes së dënimit për 5 apime dhe në të gjitha vendimet e tjera është vendosur lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.
- Për nenin 88(plagosje e rëndë me dashje) janë shqyrtuar 3 çështje penale, me 3 të pandehur me masë sigurimi “arrest burg” , 2 apime janë ushtruar nga prokurorët për masë të butë dënimi, të cilat nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit dhe një apelim nga i pandehuri që po nuk është pranuar nga Gjykata.



## **5. Rekurse.**

Prokuroria e Apelit ka ushtruar 18 rekurse (19 më pak se viti kaluar) në Gjykatën e Lartë, ku 17 rekurse janë ushtruar kundër vendimeve të themelit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe një rekurs (9 më pak se viti kaluar) jështë ushtruar kundër vendimit për caktim mase sigurimi:

Prokurori Alfred Agolli ka ushtruar në Gjykatën e Lartë 8 rekurse për vendime themeli.

Prokurori Gjon Fusha ka në Gjykatën e Lartë 10 rekurse, nga të cilat 9 për vendime themeli dhe një për vendim mase sigurimi..

## **6. Urdhëra ekzekutimi.**

- Për vitin 2017 nga prokuroria e Apelit Gjirokastrë janë lëshuar 7 urdhëra ekzekutimi të menjëhershëm.

Këto janë disa nga treguesit kryesorë e punës së kryer gjatë vitit 2017 në Prokurorinë e Apelit Gjirokastrë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**PROKURORI APELIT**  
**Alfred AGOLLI**